

Logopädie in der Schule

Logopedia në shkollë

Shërbimi i logopedisë është një ofertë e arsimit popullor. Ky është një shërbim falas në dispozicion të prindërve, fëmijëve, të rinjve, mësuesve, drejtorive shkollore dhe anëtarëve të organeve kompetente.

Gjuha ka për ne njerëzit një kuptim qendror. Me anën e gjuhës ne mundemi të shprehemi dhe të kuptohemi me njëri-tjetrin. Në çdo aktivitet gjuhësor janë të pranishme proceset fizike, shpirtërore dhe mendore. Kështu kufizimet gjuhësore veprojnë gjithnjë mbi të gjithë njeriun. Ato mund të ndikojnë në mënyrë jo të favorshme në gjendjen psikike dhe sociale si edhe në aftësinë e të mësuarit.

Kusht për zhvillimin normal gjuhësor tek fëmija është zhvillimi i perceptimit, i të menduarit, i të lëvizurit si edhe i sjelljes emocionale dhe sociale. Një përfshirje logopedike dhe terapia përmban kështu fushat e zhvillimit, që u përmendën.

Çdo terapi është e përcaktuar në mënyrë individuale sipas nevojave të fëmijës. Në formë loje dhe me prirje nga veprimet praktike fëmija drejtohet drejt mbledhjes së përvojave të reja dhe në zbulimin e gjuhës. Kështu fëmija mund të zgjerojë kompetencat e tij gjuhësore dhe drejtohet drejt shkallës pasardhëse të zhvillimit.

Nëpërmjet parandalimit – në rast nevoje nëpërmjet terapisë së hershme në moshën feminare – mendohet të mënjanohen simptomat vijuese si vështirësitë në mësimin e leximit, shkrimit dhe llogaritjes. Çrregullimet në zhvillimin e personalitetit dhe të sjelljes mund të parandalohen, respektivisht të pakësohen. Një tjetër faktor për një terapi të suksesshme është bashkëpunimi me prindërit dhe mësuesit në formën e këshillimit dhe të përkrahjes.

Logopedet dhe logopedët kanë kryer një studim kohëplotë në një universitet ose në një shkollë të lartë profesionale që njihet. Ata janë në zotërimin e një diplome logopedie që njihet nga shteti.

Prill 2010